

A mund të na dëgjoni përmes ekranit? TË RINJTË PËR NJË HAPËSIRË TË SIGURT NË INTERNET!

VETË-RREGULLIMI: ÇFARË MUND TË BËJNË PLATFORMAT E INTERNETIT?

Platformat online përmes vetë-rregullimit duhet të marrin masa dhe hapa më proaktivë në drejtim të trajtimit të disa prej sfidave më të mëdha.



Platformat e internetit duhet të përmirësojnë politikat e tyre të përdoruesve dhe të adresojnë raportimet që i bëjnë përdoruesit.



Ato duhet të zbatojnë rregulla dhe procedura më të rrepta, të verifikojnë burimet e informacionit, të bllokojnë postimet e dëmshme dhe të respektojnë kufijtë e moshës.



Dilemat dhe çështjet/problemet e mundshme të vetë-rregullimit

Platformat e internetit përfitojnë nga përdorimi shtesë, por edhe nga keqpërdorimi i platformave të tyre. Platformat mund të mos jenë të interesuara për të ndryshuar situatën aktuale.



Këto konkluzione dhe rekomandime bazohen në gjetjet nga eventet e konsultimit për të rinjtë, i krijuar për të kuptuar përvojat personale të të rinjve në internet, pozitive ose negative, dhe mendimet e tyre se cilat masa politike dhe cilat palë të interesuara/aktorë duhet të zbatojnë këto masa për të përmirësuar përvojën e përdoruesve.

Eventet e konsultimit për të rinjtë janë pjesë e projektit "Krijojmë të ardhmen së bashku: BE-ja dhe Ballkani Perëndimor nga perspektiva e të rinjve", financuar nga Agjencia Evropiane për Politikën Kulturorë, Arsimore dhe Audio-Vizuale përmes programit të saj "Evropa për Qytetarët".